Nr. prot.: 503 /26
Datë: 29 /08 /2026

Për ekskursion të maturantëve të IAAP "Skënder Luarasi" – Suharekë, në Republikën e Shqipërisë

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjencionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjencioni turistik duhet t'i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Certifikata e TVSH-së.
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë konform dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC).
- Certifikata e autobusit sipas licencës "D";
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjencioni turistik duhet të ketë dokumentacionin (licencën) e agjencionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve;
- Agjencioni duhet të ketë një dëshmi origjinale për marrëveshje me hotelin ku mendon me i dërguar nxënësit (KDSH ka përcaktuar javën e fundit të shtatorit 2026 – katër netë dhe preferon vendosjen në kompleksin Hotel Bonita – Durrës ose të ngjashme.
- Agjencioni duhet të prezantojë dëshmi: menynë ditore të plotë për secilën ditë të ekskursionit.
- Agjencioni turistik duhet t'i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i Shkollës
- Agjencioni duhet të garantojë me dëshmi (deklaratën nën betim nga OE) se do t'i mbulojë të gjitha shpenzimet gjatë vizitave në monumente kulturo-historike.
- Agjencioni duhet të na ofrojë siguri (deklaratë nën betim nga OE), në hotele dhe gjatë vizitave që do tu bëhen monumeneteve kulturo-historike.
- Agjencioni do të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tri vitet e fundit (vitet 2023-2024-2025)
- Agjencioni do të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.

- Agjecioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK, që do të marrin pjesë në ekskursion.
- Agjencioni duhet të ofrojë dëshmitë me shkrim nga hoteli se ka rezervuar vendosjen e nxënësve për datat e caktuar nga KDSH.
- Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Të sigurohet pansion i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racion i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë.
- Pavarësisht numrit të nxënësve për paralele, kujdestarët e klasave shkojnë falas në ekskursion.
- Hoteli të posedojë sallë për ballo.
- Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo-historike.
- Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (Autobusë me kondicioner).
- Mundësi vizite në qytetet: Tiranë, Durrës, Krujë, Berat, Vlorë, etj.

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA02/2016, në ambientet e DKA- së , Suharekë.

Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme:

- Çmimi ofertues
- Lloji i hotelit (kategoria e hotelit në bazë të yjeve, nr. i nxënësve nëpër dhoma)
- Menyja
- Gjendja teknike e autobusëve
- Referencat.

Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës, pas orës 14:00.

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i fituesit do të shpallet në tabelën e shpalljeve në hyrje të shkollës.

Aplikuesit e interesuar ofertat e veta duhet t'i paraqesin në dy zarfe (Në zarfin e vogël oferta e mbyllur e futur në zarfin e madh e cila përmban dokumentacionet e kërkuara nga shkolla). Ofertat dorëzohen në zyret e DKA-së në Suharekë.

Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus 1 ditë), ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit.

Afati i paraqitjes së ofertës është 7 ditë (Ditën e fundit dokumentet pranohen deri ora 13:30) nga dita e shpalljes në gazetën zyrtare.

Formulari i paraqitjes së ofertës dhe rrugëtimi i ekskursionit i hartuar nga Këshilli Drejtues i Shkollës merren në IAAP "Skënder Luarasi" nga data 25.08.2026 ora 08.00-14:00.
Pranimi i ofertave bëhet nga data 25.08.2026 deri më 03.09.2026 deri në ora 13:30 në DKA-Suharekë.
Hapja e ofertave bëhen në DKA-Suharekë me datë: 03.08.2026 në ora 14:00.

Drejtori: